



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve

JANAR – DHJETOR 2024



Ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve

JANAR – DHJETOR 2024

TITULLI:

**Ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve
(janar - dhjetor 2024)**

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

* Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes FOL dhe FIT dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të drejtat e autorit © 2025. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit.

Përmbajtja

1. Hyrje dhe gjetjet kryesore _____	7
2. Korniza ligjore për paraqitjen e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve _____	11
3. Metodologjia _____	17
4. Trajtimi i rasteve disiplinore nga sistemi Gjyqësor i Kosovës _____	19
5. Trajtimi i ankesave disiplinore nga sistemi Prokurorial i Kosovës _____	35
6 Ankesat e parashtruara tek Avokati i Popullit _____	51
7. Rekomandimet _____	52

Shkurtesat

KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
LPD	Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve
LGJ	Ligji për Gjykatat i Kosovës
LKGJK	Ligji Për Këshillin Gjyqësor Të Kosovës
LKPK	Ligji Për Këshillin Prokurorial Të Kosovës
LPSH	Ligji Për Prokurorin E Shtetit
LGJK	Ligji Për Gjykatën Komerciale
KPP	Kodi I Procedurës Penale

1. Hyrje dhe gjetjet kryesore

Krijimi i institucioneve gjyqësore të pavarura, të paanshme dhe të mbrojtura nga çdo formë ndikimi është domosdoshmëri për funksionimin e një shteti demokratik. Këto parime janë veçanërisht të rëndësishme në raport me gjyqtarët dhe prokurorët, pasi përbëjnë themelin mbi të cilin ndërtohet një sistem funksional dhe i besueshëm.

Respektimi i integritetit dhe etikës profesionale nga ana e zyrtarëve gjyqësor është thelbësor për ruajtjen e besimit të qytetarëve në drejtësi. Megjithatë, në raste të caktuara, sjellja e papërshtatshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve mund ta vë këtë integritet në rrezik. Për këtë arsye, krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe sistematik për trajtimin e ankesave disiplinore bëhet i domosdoshëm, duke përfshirë hetimin dhe ndëshkimin e çdo shkeljeje që cenon standardet profesionale dhe ligjore të funksionarëve të drejtësisë.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë tash e sa vite po vazhdon të përballet me sfida e vështirësi. Ndër këto sfida përfshijnë ngarkesën e madhe me lëndë në sistem kundrejt numrit të kufizuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo shpie në probleme të shumta, duke filluar nga stërzgjatja e procedurave gjyqësore, shkelja e afateve procedurale, numri i madh i lëndëve të parashkruara, etj.. Si pasoj, kjo zbehë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Rrjedhimisht, është e rëndësishme të investojmë në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar në lidhje me mundësinë dhe procedurën e parashtrimit të ankesave disiplinore, në mënyrë që të adresohet edhe çështja e besimit të ulët të qytetarëve tanë në sistemin e drejtësisë.

Për të analizuar çështjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës në trajtimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë një periudhe të caktuar kohore, përkatësisht gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Lëvizja FOL ka hartuar këtë raport, në mënyrë që të ofroj rekomandime kyçe drejt ngritjes së efikasitetit të sistemit të drejtësisë në trajtimin e këtyre ankesave.

Ky raport paraqet vazhdimin e monitorimit të praktikës disiplinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës nga FOL, duke qenë i dyti me radhë pas publikimit të raportit të parë për vitin 2023.¹

1 Për më tepër, shih: [Raport mbi ankesat disiplinore të parashtruara gjatë vitit 2023](#)

Në pjesën vijuese të këtij kapitulli është paraqitur një përmbledhje e të gjeturave kryesore të këtij raporti.

→ Gjatë vitit 2024, KGjK ka demonstruar një praktikë të konsoliduar të transparencës duke publikuar të gjitha vendimet për refuzimin ose hedhjen e ankesave disiplinore nga Autoritetet Kompetente, në seksionet përkatëse të gjykatave në ueb-faqen zyrtare të KGjK-së.

Në të kundërtën, KPK nuk ka ndjekur të njëjtin standard, duke vazhduar praktikën e mospublikimit të shumicës së vendimeve të Autoriteteve Kompetente.

Nga gjithsej 51 vendime disiplinore për refuzim ose hedhje të ankesave ndaj prokurorëve, vetëm 14 (27.5%) janë publikuar, ndërsa 37 vendime (72.5%) nuk janë bërë të qasshme për publikun në faqen zyrtare të KPK-së. Kjo përbën një mangësi serioze sa i përket transparencës, duke kufizuar llogaridhënien dhe qasjen e publikut në informacionet që ndërlidhen me funksionimin e sistemit disiplinor në sistemin prokurorial.

Një situatë e ngjashme u konstatua edhe gjatë vitit 2023, ku, ndonëse vendimet mbi refuzimin apo hedhjen e ankesave disiplinore nga kryetarët e gjykatave u publikuan rregullisht në ueb-faqen e KGjK-së, vendimet përkatëse të kryeprokurorëve të prokurorive u trajtuar si të dhëna konfidenciale dhe nuk janë publikuar në ueb-faqen e KPK-së.

Për më tepër, pas ankesës së FOL, me vendimin Nr. AP-397/2024 të datës 24 qershor 2024, AIP e obligoi KPK-në të lejojë qasje në dokumentet e kërkuara nga FOL, duke konstatuar se mohimi i qasjes ka qenë i pajustificueshëm dhe përbënte shkelje të të drejtave për qasje në dokumente publike.²

→ Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, qytetarët (personat fizik dhe juridik) kanë paraqitur gjithsej 124 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të Republikës së Kosovës. 94% e këtyre ankesave (117) janë refuzuar ose hedhur poshtë nga autoritetet kompetente të gjykatave, ndërsa janë inicuar 9 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore në KGjK.

Situatë e njëjtë e ankesave ishte edhe gjatë vitit 2023, ku qytetarët kishin paraqitur 125 ankesa ndaj gjyqtarëve, 95% e të cilave ishin refuzuar/hedhur nga autoriteti kompetent.

→ Gjatë vitit 2024, KGjK ka marrë 9 vendime disiplinore, nga të cilat janë shqiptuar këto masa:

- Vërejtje publike me shkrim - 2 raste;
- Vërejtje jopublike me shkrim - 2 raste;
- Zvogëlim i përkohshëm i pagës për 50% deri në një vit - 1 rast;
- Lirim nga përgjegjësia - 4 raste.

2 Për më shumë, shih raportin: <https://levizjafol.org/ep-content/uploads/2025/01/82-Ankesat-disiplinore-ALB01.pdf>

Ndërsa gjatë vitit 2023, KGJK kishte marrë masa më të larmishme dhe në disa raste më të ashpra, përfshirë 2 propozime për shkarkim, 1 vendim për vërejtje publike me shkrim të shoqëruar me zvogëlim të përkohshëm të pagës për 40% për katër muaj, 2 vërejtje të tjera publike me shkrim, 4 vendime për lirim nga përgjegjësia disiplinore, si dhe 1 vendim për transferim të përhershëm të një gjyqtari brenda gjykatës.

Krahasuar me vitin paraprak, gjatë vitit 2024 vërehet një prirje drejt masave më të lehta disiplinore dhe mungesë e masave si propozimi për shkarkim apo transferimi i përhershëm.

- Për rastet e trajtuara nga kryetarët e gjykatave, në përgjithësi është konstatuar respektim i afateve ligjore në trajtimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve, gjë që tregon një shkallë të lartë efikasiteti procedural në vendimmarrjen mbi ankesat disiplinore, duke marrë parasysh së në të gjitha rastet është vendosur brenda afatit ligjor, me përjashtim të një vendimi, në të cilin ishte vendosur me 8 ditë vonesë.³

Në krahasim me vitin 2023, situata paraqitet më e përmirësuar, pasi atë vit në 5 raste kryetarët e gjykatave kishin vendosur jashtë afatit ligjor.

- Gjatë vitit 2024, qytetarët kanë parashtruar 58 ankesa disiplinore ndaj prokurorëve, ku 54 nga këto ankesa (93%) ishin refuzuar ose hedhur nga autoritetet kompetente, ndërsa janë parashtruar 6 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore në KPK. Kjo tregon se shumica dërrmuese e ankesave nuk kanë kaluar fazën fillestare të shqyrtimit nga autoritetet përkatëse.

Numri i ankesave të parashtruara gjatë këtij viti tregon se ka pasur ulje të theksuar të parashtrimin të ankesave ndaj prokurorëve në krahasim me vitin 2023, kur ishin parashtruar 71 ankesa ndaj prokurorëve, 87% e të cilave ishin refuzuar/hedhur nga ana e autoriteteve kompetente.

- KPK gjatë kësaj periudhe ka marrë 4 vendime disiplinore për lëndët e vitit 2024, duke shqiptuar këto masa:
- Vërejtje jopublike me shkrim - 2 raste;
 - Zvogëlim i pagës për 30% për 6 muaj - 1 rast;
 - Zvogëlim i pagës për 20% për 3 muaj - 1 rast.

Ndërsa në vitin 2023, KPK kishte marrë 5 vendime disiplinore, të cilat përfshinin: 2 vërejtje jopublike me shkrim, 2 vërejtje publike me shkrim dhe 1 vendim për ulje të pagës për 30% për një vit.

3 Vendimi APGJA.nr.6/2024 (ankesa është bërë me 15 korrik 2024, vendimi është marrë me 23 gusht 2024).

Si në vitin 2023, ashtu edhe në vitin 2024, pjesa më e madhe e masave disiplinore të shqiptuara nga KPK kanë qenë vërejtjet, qoftë publike apo jopublike, duke treguar një prirje drejt sanksioneve më të lehta disiplinore.

- Sa i përket respektimit të afateve ligjore nga sistemi prokurorial, në vendimet e publikuara shihet se autoritetet kompetente kanë vepruar brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe rregullore. Në rastet e analizuara, nuk janë evidentuar tejkalime të afateve procedurale. Megjithatë, meqenëse vetëm një pjesë e vogël e vendimeve janë publikuar, mbetet sfiduese të bëhet vlerësim.
- Gjatë vitit 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar 12 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prej tyre:
 - 8 ankesa janë shpallur të papranueshme;
 - Në 3 raste, KGjK dhe KPK nuk kanë konstatuar shkelje disiplinore;
 - 1 rast është ende në fazën e hetimit.

Numër relativisht të njejtë të paraqitjes së ankesave disiplinore tek Avokati i Popullit kshte edhe gjatë vitit 2023, kur ishin paraqitur 12 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku 1 prej tyre ishte shpallur e papranueshme. Megjithatë, edhe atëherë KPK dhe KGjK nuk kishin gjetur shkelje disiplinore.

Para se të thellohet në të dhënat për numrin e ankesave të parashtruara në secilën gjykatë/prokurori dhe tek Avokati i Popullit, ky raport do të shqyrtojë strukturën ligjore të Kosovës, veçanërisht në lidhje me procedurat disiplinore të aplikueshme për gjyqtarët dhe prokurorët brenda kornizës kushtetuese të Kosovës.

2. Korniza ligjore për paraqitjen e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve

Çështja e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazohet në Kushtetutën e Kosovës⁴, dhe më tej rregullohet me Ligjin Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës⁵, Ligjin Nr. 06/L - 054 për Gjykatat⁶, Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës⁷ dhe me ndryshimin e këtij ligji të miratuar në vitin 2025⁸, Ligji Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit⁹, dhe Ligjin Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve¹⁰, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në nëntor 2018, si dhe me ndryshimin e këtij ligji të miratuar në vitin 2021.¹¹

Kushtetuta e Kosovës – Sistemi Gjyqësor dhe Prokurorial

Kushtetuta e Kosovës¹² përcakton kornizën rregullative për sistemin gjyqësor të Kosovës. Ai përshkruan parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies gjyqësore. Kushtetuta sanksionon strukturën e gjyqësorit, duke përfshirë Gjykatën Supreme, Gjykatën Kushtetuese dhe organet e tjera gjyqësore. Ai përcakton emërimin, mandatin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, duke siguruar profesionalizmin dhe integritetin e tyre. Për më tepër, Kushtetuta garanton qasje në drejtësi, proces të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave themelore për të gjithë qytetarët.

Sa i përket instrumenteve disiplinore lidhur me gjyqtarët, Kushtetuta e Kosovës ofron bazën për kornizën disiplinore për gjyqtarët. Siç ndodh zakonisht, Kushtetuta përfshin dispozita që përshkruajnë arsyet për shkarkimin e gjyqtarëve, duke shërbyer si masë e fundit. Këto baza përfshijnë vepra të rënda penale ose mosrespektim të rëndë të detyrave (shkelje e rëndë).

4 Kushtetuta e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

5 Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18335>

6 Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

7 Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18920>

8 Ligji nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=105944>

9 Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=74943>

10 Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18336>

11 Ligji nr. 08/L - 003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve,

12 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18336>

Më konkretisht, neni 104(4) specifikon se *"Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave"*, duke përshkruar sanksionet përfundimtare të zbatueshme për gjyqtarët në rrethana të tilla.

Ky nen ka vendosur një standard të lartë kur i referohet veprave penale si bazë për shkarkimin nga puna, pasi sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), krimet e rënda përfshijnë i) të gjitha krimet e dënueshme me 10 vjet e më shumë dhe vepra të tjera, të përcaktuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale.

Ky nen vendos një standard të lartë duke identifikuar veprat e rënda penale si arsye për shkarkim. Është e rëndësishme të theksohet se përkufizimi i "krimeve të rënda" sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) fokusohet në veprat e dënueshme me 10 ose më shumë vjet burgim ose krime të renditura në mënyrë eksplicite. Ky përkufizim mund të anashkalojë një sërë veprash penale që, megjithëse nuk përmbushin pragun 10-vjeçar, ende cenojnë ndjeshëm integritetin e gjyqësorit.

Për më tepër, Kushtetuta mandaton Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) si organ kushtetues për të zhvilluar procedura disiplinore kundër gjyqtarëve (neni 108(3)) dhe për të kryer inspektime gjyqësore (neni 108(5)). Për të miratuar këto dispozita, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë tri akte kryesore legjislative që rregullojnë sjelljen e pahijshme gjyqësore dhe masat e tij ndëshkuese: Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinor të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili shërben si një legjislacion gjithëpërfshirës që mbulon si gjyqtarët ashtu edhe prokurorët.

Ngjashëm me sistemin e gjyqësor, Kushtetuta e Kosovës përcakton parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies edhe të prokurorisë. Sipas nenit 109, paragrafi 6 i Kushtetutës, *"[prokurorët mund të shkarkohen nga detyrat e tyre nëse dënohen për një vepër të rëndë penale ose për neglizhencë të konsiderueshme të detyrave të tyre]"*. Kjo dispozitë pasqyron të njëjtën kërkesë të vendosur për gjyqtarët.

Përveç kësaj, neni 110 (2) i Kushtetutës përcakton se Këshilli Prokurorial i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin, propozimin, avancimin, transferimin, riemërimin dhe disiplinimin e prokurorëve në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj.

LIGJI PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (LKGJK) rregullon organizimin dhe funksionimin e këshillit, si institucion përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë, integritetit dhe llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë. Ai përshkruan përbërjen e këshillit, duke përfshirë emërimin dhe mandatin e anëtarëve të tij, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Ligji trajton gjithashtu procedurat për përzgjedhjen, vlerësimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve, duke synuar të ruajë standardet më të larta të profesionalizmit dhe etikës brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

Në këtë drejtim, LKGJK parasheh që KGJK-ja është e autorizuar të vendosë për disiplinën e gjyqtarëve (neni 7(1.14)) dhe se ka mandat të miratojë Kodin e Etikës për Sjelljen Profesionale për gjyqtarët (neni 7(1.19)). Përveç disiplinimit të gjyqtarëve, KGJK-ja trajton edhe disiplinimin

e anëtarëve të KGJK-së. Megjithatë, ky aspekt nuk do të mbulohet në këtë analizë pasi bie jashtë fushëveprimit të raportit.

Është e rëndësishme të theksohet se LKGJK (neni 39), përcakton që të gjitha çështjet në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të trajtohen në përputhje me kornizën disiplinore të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinor dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga Këshilli, të cilat ky raport do t'i shqyrtojë në pjesët vijuese të këtij raportit.

Kur bëhet fjalë për mbrojtjen ligjore për gjyqtarët që përballen me sanksione disiplinore, sipas nenit 32 të LKGJK-së, i cili lidhet me nenin 104 (5) të Kushtetutës, gjyqtarët janë të autorizuar me të drejtën për të paraqitur ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me vendimet e marra nga KGJK. Këto vendime përfshijnë masa disiplinore, të cilat mund të rezultojnë në uljen në detyrë të gjyqtarit dhe në këto raste - kur vendimet disiplinore rezultojnë në ulje në detyrë për gjyqtarët - ata kanë mundësinë të bëjnë ankim direkt në Gjykatën Supreme për shqyrtim.

LIGJI PËR GJYKATAT

Ligji për Gjykatat rregullon organizimin, juridiksionin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Ajo themelon nivelet e ndryshme të gjykatave, duke përfshirë gjykatat themelore, me degët e saj, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Për më tepër, ai përshkruan procedurat për emërimin e gjyqtarëve dhe personelit tjetër të gjykatës, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Ligji trajton gjithashtu çështje të tilla si administrimi i gjykatës, etika gjyqësore dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit.

Ligji për Gjykatat përcakton udhëzime për profesionalizmin dhe detyrat e gjyqtarëve, të përshkruara kryesisht në nenet 40 dhe 41.

Neni 40 i ligjit përcakton se gjyqtarët duhet të sillen me objektivitet, paanshmëri dhe pavarësi, në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Profesionale të Gjyqtarëve. Për më tepër, gjyqtarët pritët të demonstrojnë disponueshmëri, respekt për palët dhe dëshmitarët dhe vigjilencë në ruajtjen e nivelit më të lartë të kompetencës gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre. Atyre u kërkohet gjithashtu të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit jopublik të hasur gjatë funksioneve të tyre gjyqësore dhe të përmbahen nga komentet në media për detajet e çështjes ose përfshirja në komunikime ex-parte. Për më tepër, gjyqtarët inkurajohen të angazhohen në programet e edukimit të vazhdueshëm ligjor për të rritur kompetencën dhe efektivitetin e tyre profesional.

Nga ana tjetër, neni 41 parashikon ndalimet e sjelljes së gjyqtarëve. Ai urdhëron që gjyqtarët duhet të përmbahen nga kryerja e çdo detyre apo shërbimi që mund të rrezikojë pavarësinë, paanshmërinë e tyre, ose në ndonjë mënyrë tjetër bie ndesh me detyrat e tyre gjyqësore ose me dispozitat e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët në Kosovë. Kjo siguron që gjyqtarët të ruajnë integritetin dhe paanshmërinë e tyre në të gjitha aspektet e sjelljes së tyre profesionale. Për më tepër, gjyqtarëve u ndalohet të jenë anëtarë të subjekteve politike ose të marrin pjesë në ndonjë aktivitet politik, duke përfshirë kandidimin, mbajtjen ose ushtrimin e ndonjë posti politik. Ky ndalim mbron neutralitetin dhe pavarësinë e gjyqësorit, duke ruajtur besimin dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

LIGJI PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (LKPK), së bashku me Ligjin nr. 08/l-249 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/l-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës¹³, përshkruan përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e KPK-së, të cilat përfshijnë rekrutimin, propozimin, avancimin, transferimin, riemërimin dhe veprimet disiplinore në lidhje me prokurorët. Ai parashikon procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të KPK-së, mandatin e tyre dhe mekanizmat për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe paanshmërisë në proceset vendimmarrëse të keshillit.

Për sa i përket disiplinimit të prokurorëve, ai parashikon se KPK është i autorizuar të vendosë për disiplinën e prokurorëve (neni 7(1.11)) dhe se është i mandatuar të miratojë Kodin e Etikës për Sjelljen Profesional për prokurorët (neni 7 (1.15)) dhe përcakton procedurat për seancat dhe zhvillimin e seancave disiplinore (neni 7(1.22)).

Ngjashëm me LKGJK-në, edhe LKPK-ja (neni 34), drejton që të gjitha çështjet në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve të trajtohen në përputhje me kornizën disiplinore të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga Këshilli, të cilat do t'i shqyrtojë ky raport. në pjesët vijuese të këtij raporti.

LIGJI PËR PROKURORIN E SHETIT

Ligji për Prokurorin e Shtetit përshkruan rolin, përgjegjësitë dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit brenda kornizës ligjore të Kosovës. Ky ligj themelon Prokurorin e Shtetit si institucion të pavarur, përgjegjës për ndjekjen e veprave penale në emër të shtetit. Ai përcakton procesin e emërimit dhe mandatin e prokurorëve të shtetit, si dhe strukturën organizative të Prokurorisë së Shtetit.

Ligji për Prokurorin e Shtetit ndryshon nga Ligji për Gjykatat në atë që ndalon avancimet për prokurorët të cilëve i'u janë nënshtruar masave disiplinore, me përjashtim të rasteve të qortimit apo vërejtjes jopublike brenda pesë viteve të fundit. Kjo është një masë pozitive që meriton mirënjohje.

Neni 38 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit fokusohet në sjelljen e prokurorëve. Ai i ndalon prokurorët të përdorin pozicionin e tyre ose reputacionin e prokurorisë për përfitime personale. Ata gjithashtu janë të ndaluar të kryejnë çdo detyrë që mund të rrezikojë pavarësinë ose paanshmërinë e tyre. Gjithashtu, prokurorëve u ndalohet të lidhen me subjekte politike ose të angazhohen në aktivitete politike, duke siguruar neutralitetin dhe integritetin e tyre në kryerjen e detyrave të tyre.

Ngjashëm me Ligjin për Gjykatat, ky ligj gjithashtu përcakton kritere të ndryshme për emërimin e prokurorëve në krahasim me fillimin e procedurës disiplinore ndaj tyre, veçanërisht për kryerjen e veprave penale. Me rastin e emërimit të prokurorëve, neni 24 (1.5) përcakton se kandidatët nuk duhet të jenë dënuar për vepër penale, me përjashtim të veprave të kryera nga pakujdesia.

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 1 / 21 maj 2025, Prishtinë, Ligjin nr. 08/l-249 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/l-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Megjithatë, fillimi i procedimeve disiplinore ndaj prokurorëve lidhur me kryerjen e veprave penale do të përfshinte një sërë kriteresh të dallueshme. Kjo do të thotë se ata mund të shkaktohen nga kryerja e çdo veprë penale, pavarësisht nëse është kryer nga pakujdesia apo jo.

LIGJI PËR PËRGJEGJËSINË SDISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (LPD) rregullon më tej çështjet disiplinore brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Ky ligj përshkruan procedurat për hetimin e pretendimeve për sjellje të pahijshme ose shkelje të etikës profesionale nga gjyqtarët dhe prokurorët. Ligji përcakton procesin disiplinor, duke përfshirë të drejtat e të akuzuarve dhe përgjegjësitë e organeve disiplinore të përfshira. Dispozitat e tij janë ndërtuar për të mbështetur integritetin, pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke garantuar procedime disiplinore të drejta dhe transparente.

Para hyrjes në fuqi të këtij ligji, zhvillimi i procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është bërë përmes Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD). Ky ishte institucion i pavarur, që kompetencë kishte hetimin e supozimeve për mos përbushje ose kryerje të pahijshme të detyrave të punës nga prokurorët dhe gjykatësit. Mirëpo, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, përkatësisht që nga dhjetori i vitit 2018, ZPD është shuar dhe kompetencat e tij i janë deleguar KGJK-së dhe KPK-së.

Neni 7 i LPD - së përcakton sanksionet disiplinore që mund të shqiptohen nga KGJK dhe KPK ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve nëse shpallen përgjegjës për shkelje disiplinore.

Masat disiplinore përfshijnë vërejtjen me shkrim jopublik, të komunikuar privatisht gjyqtarëve dhe prokurorëve të interesuar, duke treguar keq bërjen e tyre dhe nevojën për veprime korigjuese dhe vërejtjen me shkrim publik, e cila nënkupton pranimin publik të shkeljes disiplinore dhe nevojën për veprime korigjuese që duhen ndërmarrë nga gjyqtari në fjalë. Në rastet kur shkelja kërkon masa më të rënda, si sanksion disiplinor mund të vendoset një ulje e përkohshme e pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit. Ky ndëshkim financiar shërben si parandalues dhe pasqyron peshën e veprës penale.

Për më tepër, Këshillat kanë autoritetin të urdhërojnë një transferim të përkohshëm ose të përhershëm të individit në një gjykatë/prokurori të nivelit më të ulët. Kjo masë mund të veprojë si masë disiplinore duke siguruar gjithashtu që sjellja e individit të monitorohet nga afër në një mjedis të ndryshëm profesional.

Së fundi, në rastet më të rënda të sjelljes së pahijshme, Këshillat mund të propozojnë shkarkimin e individit nga pozicioni i tyre si gjyqtar. Kjo përfaqëson masën përfundimtare disiplinore dhe rezervohet për vepra që cenojnë ndjeshëm integritetin dhe besueshmërinë e gjyqësorit.

Neni 8 i LPD-së përcakton bazat për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ai përcakton se Presidenti i Republikës së Kosovës ka autoritetin për të shkarkuar një gjyqtar/prokuror. Mirëpo, ky vendim mund të merret vetëm në bazë të propozimit të KGJK-së dhe KPK-së. Për sa i përket shkaqeve të shkarkimit, KGJK dhe KPK mund të propozojnë shkarkimin e gjyqtarit/prokurorit vetëm nëse dënohen për ndonjë vepër të rëndë penale, ose nëse konstatohet se kanë neglizhuar rëndë detyrat e tyre.

RREGULLORJA E KGJK -së DHE KPK-së PËR PROCEDURËN DISIPLINORE NDAJ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK ka nxjerrë Rregulloren për Procedurën Disiplinore ndaj Gjyqtarëve, e cila ka filluar të zbatohet nga korriku 2019. Njësoj si KGJK, KPK ka miratuar Rregulloren për Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve, e cila ka filluar të zbatohet nga qershori 2019.

Procesi disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët i përcaktuar në ligj dhe në këto rregullore, zakonisht ndjek një grup specifik hapash, siç detajohet më poshtë:

- Fillimisht, ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkeljet disiplinore të tyre dërgohen tek Autoritetet Kompetente.¹⁴ Ankesat gjithashtu mund të dërgohen edhe tek Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili të njëjtat i drejton tek autoritetet kompetente. Në këtë rast, duhet theksuar se LPD ka lënë zbrazëti juridike në përcaktimin e Autoritetit Kompetent për disa kategori të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht për: gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, prokurorët e angazhuar në Zyrën Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe ndaj gjyqtarëve të degëve të gjykatave themelor.
- Pas pranimit të ankesës, Autoriteti Kompetent e shqyrton atë në afat prej 30 ditësh, dhe pas shqyrtimit autoriteti mund t'a hedh poshtë ankesën, t'a refuzoj, ose të kërkoj fillimin e hetimeve (me ç'rast krijohen panelet hetimore në këshillat përkatës). Ligjvënësi nuk ka lënë mundësinë e ankimimit ndaj këtyre vendimeve.
- Panelet Hetimore të këshillave përkatës zhvillojnë hetimet brenda 3 muajve nga dita e themelimit. Nëse ka rrethana të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës, këshilli mund të zgjas hetimet edhe për 2 muaj.
- Pas 15 ditësh prej përfundimit të hetimeve, paneli i dërgon raport këshillit përkatës. Pas 30 ditësh prej ditës së dërgimit të raportit, këshilli e cakton seancën dëgjimore dhe e merr vendimin.
- Siç është përmendur edhe më lartë, në rast se evidentohet se gjyqtarët dhe prokurorët kanë kryer shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund t'u shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim:
 - Vërejtje jopublike me shkrim;
 - vërejtje publike me shkrim;
 - zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë 50% për një periudhë deri në 1 vit;
 - transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët;
 - propozim për shkarkim.

Sipas ligjit, me përjashtim të vërejtjes jopublike, të gjitha vendimet përfundimtare mbi sanksionet disiplinore publikohen pa vonesë, por jo më vonë se 15 ditë nga këshillat përkatës në faqen e tyre zyrtare.

¹⁴ Autoritete Kompetente janë: Kryetarët e Gjykatave Themelore (për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse); Kryetari i Gjykatës së Apelit (për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit); Kryetari i Gjykatës Supreme (për shkeljet disiplinore të kryetarëve të gjykatave themelore dhe të kryetarit të Gjykatës së Apelit); Këshilli Gjyqësor i Kosovës (për shkeljet disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme); Kryetarët e Prokurorive Themelore (për shkeljet disiplinore të prokurorëve të prokurorive përkatëse); Kryeprokurori i Shtetit (për shkeljet disiplinore të Kryeprokurorëve të Prokurorive); Këshilli Prokurorial i Kosovës (për shkeljet disiplinore të Kryeprokurorit të Shtetit).

3. Metodologjia

Lëvizja FOL, përmes këtij raporti, synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të numrit të ankesave për shkelje disiplinore të qytetarëve të bëra ndaj gjyqtarëve/prokurorëve gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 dhe fatit të tyre pas shqyrtimit nga ana e Autoriteteve Kompetente të gjykatave dhe prokurorive, si dhe për mënyrën e vendosjes së tyre nga ana e këshillave përkatës.

Vendimet mbi ankesat disiplinore të Autoriteteve Kompetente të publikuara në ueb-faqet zyrtare të tyre janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së monitorimit. Gjithashtu, për nevojat e këtij raporti, FOL ka përdorur metodën e mbledhjes së të dhënave kuantitative, si numri i ankesave të pranuara, numri i ankesave të refuzuara, numri i ankesave të hedhura dhe numri i kërkesave për fillim të hetimeve në KGJK dhe KPK. Këto të dhëna janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike nga Autoritetet Kompetente - kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive, KGJK dhe KPK, si dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

Lëvizja FOL ka analizuar edhe vendimet mbi hedhjen/refuzimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve, të cilat ishin të publikuara në ueb-faqen e KGJK-së dhe KPK-së, përkatësisht në domenet e gjykatave dhe prokurorive. Vendimet e publikuara janë analizuar me qëllim të vlerësimit nëse autoritetet kompetente kanë vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe rregulloret e miratuara nga këshillat. Vëmendje e veçantë i është kushtuar nëse ankesat janë shqyrtuar brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Rëndësi e veçantë në këtë raport i është kushtuar edhe analizimit të kornizës ligjore për parashtrimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe qartësisht të hapave/procedurës së paraqitjes së ankesave disiplinore. Gjithashtu, në bazë të të gjeturave të këtij raporti, FOL në fund ka dhënë një listë rekomandimesh për institucionet relevante, me qëllim të ngritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve disiplinore.

Ky është raporti i dytë me radhë i monitorimit të vendimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të bërë nga FOL, që pason raportin e parë të publikuar për vitin 2023.¹⁵

15 [Ankesat disiplinore janar-dhjetor 2023.](#)



Trajtimi i rasteve disiplinore nga sistemi Gjyqësor i Kosovës

4. Trajtimi i rasteve disiplinore nga sistemi Gjyqësor i Kosovës

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, qytetarët kanë parashtruar 124 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës¹⁶.

Pjesa dërmuese e ankesave disiplinore të parashtruara gjatë kësaj periudhe, përkatësisht 117 ankesa disiplinore (94% e ankesave), ishin refuzuar/hedhur nga autoritetet kompetente të gjykatave, ndërsa ishin bërë 9 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore në KGJK.

Kjo nënkupton se vetëm një përqindje shumë e ulët e ankesave disiplinore ka arritur të kalojë fazën fillestare të shqyrtimit nga autoritetet kompetente, duke reflektuar një shkallë të ulët të arritjes së tyre drejt procedurave hetimore në KGJK.

Numri i ankesave disiplinore të parashtruara nuk ka ndryshuar shumë nga viti paraprak (viti 2023), ku ishin parashtruar 125 ankesa disiplinore, 119 prej të cilave ishin refuzuar/hedhur nga autoritetet kompetente dhe ishin bërë 6 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore.¹⁷

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike numri i ankesave disiplinore të parashtruara gjatë vitit 2024, numri i ankesave të hedhura/refuzuara, si dhe numri i kërkesave për fillim të hetimeve.

¹⁶ Të dhëna të siguruara përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ndaj të gjitha gjykatave. Kërkesat për qasje në dokumente publike janë bërë me datë 16.04.2024.

¹⁷ Për më tepër, shih raportin: [Ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve \(janar-dhjetor 2023\)](#)

**119**

Ankesat e
hedhura/
refuzuara

125

Ankesat e parashtruara

6

Kërkesat
për fillim të
hetimeve

FIGURA 1

Të dhënat statistikore në lidhje me numrin e ankesave të parashtruara, numrin e ankesave të hedhura/refuzuara, si dhe numrin e kërkesave për fillim të hetimeve në KGJK.

Të dhënat nga monitorimi tregojnë se një pjesë e madhe e ankesave ndaj gjyqtarëve janë refuzuar sepse nuk përmbajnë elemente të mjaftueshme të shkeljes disiplinore, sipas kriterëve ligjore. Në rastet e tilla, vlerësimi nga Autoritetet Kompetente konkludon se faktet e paraqitura nuk i përmbushin pragjet minimale për hapjen e hetimit për shkelje disiplinore.

Ajo që është e rëndësishme të përmendet, është se ndryshe nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në KGJK të gjitha vendimet mbi ankesat disiplinore të gjykatave janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, tek domenet e gjykatave.

Të gjitha vendimet janë analizuar në kuptim të përmbushjes së afateve të përcaktuara me ligj për shqyrtimin/trajtimin e tyre. Gjithashtu, janë shqyrtuar edhe shkaqet për paraqitjen e ankesave dhe arsyetimi i vendimeve.

Në pjesën vijuese të raportit do të paraqiten të dhënat në lidhje me numrin e ankesave të parashtruara dhe trajtimin e tyre nga autoritetet kompetente të gjykatave të Kosovës, si dhe të dhënat në lidhje me numrin e vendimeve dhe masave disiplinore të marra nga KGJK. Përmes paraqitjes së këtyre të dhënave do të pasqyrohet vëllimi i punës së autoriteteve kompetente dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në trajtimin e rasteve disiplinore.


Gjykata Supreme e Kosovës

Sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës Supreme është Autoritet Kompetent për shkeljet disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, ndonëse pasojë e ndonjë lëshimi, kryetarit të këtij institucioni nuk i është mvëshur në mënyrë shprehimore edhe kompetenca e shqyrtimit të ankesave ndaj gjyqtarëve që shërbejnë në Gjykatën Supreme, por vetëm ndaj kryetarëve të instancave më të ulëta (Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore). Pra për gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk është përcaktuar adresa se ku duhet të parashtrohen ankesat disiplinore.

Sipas të dhënave të siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, qytetarët kanë parashtuar **16 ankesa disiplinore** ndaj kryetarëve të gjykatave të instancave më të ulëta (Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore), si dhe ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme¹⁸. Në krahasim me vitin 2023, numri i ankesave të parashtuara gjatë këtij viti nga qytetarët ishte ulur për 10 sosh.

Të gjitha këto ankesa ishin refuzuar/hedhur poshtë nga ana e Autoritetit Kompetent dhe nuk ishte bërë ndonjë kërkesë për fillim të hetimeve në KGjK.

Të gjitha vendimet për hedhje/refuzim të ankesave ishin publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të KGjK-së, përkatësisht në domenin e Gjykatës Supreme. Gjithashtu, duhet theksuar se për të gjitha ankesat disiplinore është vendosur brenda afatit ligjor të përcaktuar, duke reflektuar një shkallë të lartë efikasiteti në trajtimin e tyre nga ana e autoritetit përkatës.



Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	1
Numri i ankesave të refuzuara	12
Numri i ankesave të hedhura	2
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0
Suspendim i procedurës	1

TABELA 1

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjykata e Apelit

Sipas LPD-së, Kryetari i Gjykatës së Apelit është Autoritet Kompetent për sa i përket pretendimeve për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.

Gjatë vitit 2024, në Gjykatën e Apelit kanë shërbyer **55 gjyqtarë**.¹⁹ Ndërsa, sipas përgjigjeve të pranuar nga zyrtarët e kësaj gjykate, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 në periudhën janar-dhjetor 2024 janë paraqitur **6 ankesa disiplinore** ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit. Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga Autoriteti Kompetent, pa u iniciuar ndonjë kërkesë për fillimin e hetimeve në KGJK.

Numri i ankesave të parashtruara gjatë këtij viti ka shënuar ulje në krahasim me vitin 2023, kur ishin evidentuar gjithsej 10 ankesa disiplinore.

Rrjedhimisht, sipas të dhënave të pranuar, në këtë vit nuk ka pasur ndonjë kërkesë për fillim të hetimeve në KGJK.

Nga monitorimi në ueb-faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit është evidentuar se janë publikuar të gjitha vendime disiplinore mbi refuzimin e ankesave disiplinore të palëve. Në të gjitha këto vendime është konstatuar se është vendosur brenda afatit të paraparë në Rregulloren e KGJK-së, me përjashtim të një vendimi, në të cilin ishte vendosur me 8 ditë vonesë.²⁰



55

Numri i ankesave të parashtruara	6
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	6
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 2 Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

¹⁹ Gjykata e Apelit, Raporti vjetor i punës për vitin 2024.

²⁰ Vendimi APGJA.nr.6/2024 (ankesa është bërë me 15 korrik 2024, vendimi është marrë me 23 gusht 2024).

Gjykata Komerciale

Për shkak së është krijuar më vonë²¹, procedura e parashtrimit të ankesave për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale nuk është paraparë në LPD, por në Ligjin 08/L-015 për Gjykatën Komerciale është përcaktuar se për çështjen e ndalesave për sjelljen e gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe përgjegjësinë disiplinore të tyre, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat përkatëse të Ligjit në fuqi për Gjykatat dhe LPD-së. Në këtë kuadër, në mënyrë të ngjashme siç është përcaktuar për gjykatat tjera, ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate, ankesa parashtrohet tek kryetari i Gjykatës Komerciale.

Në Gjykatën Komerciale gjatë vitit 2024 kanë ushtruar funksionin **17 gjyqtarë**.²² Ndërkaq, gjatë kësaj periudhe qytetarët kanë parashtruar **3 ankesa disiplinore** ndaj këtyre gjyqtarëve. Të gjitha këto ankesa janë refuzuar si të pabazuara nga kryetari i kësaj gjykate - Autoriteti Kompetent. Rrjedhimisht, nuk ishte bërë ndonjë kërkesë për fillim të hetimeve në KGJK.

Ky numër i ankesave kishte rënë dukshëm në raport me vitin 2023, ku ishin parashtruar 8 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Numri i ankesave për vitin 2024 ka shënuar një rënie të dukshme krahasuar me vitin paraprak (2023), kur ishin evidentuar gjithsej 8 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Sipas monitorimit të kryer në faqen zyrtare të KGJK-së, të gjitha vendimet mbi këto ankesa janë publikuar në seksionin përkatës të Gjykatës Komerciale. Për të gjitha rastet është vendosur brenda afatit të paraparë me Rregulloren e KGJK-së, gjë që dëshmon për efikasitetet të lartë në trajtimin e rasteve disiplinore në këtë institucion.



18

Numri i ankesave të parashtruara	3
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	3
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 3

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Komerciale gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

21 Gjykata Komerciale e Kosovës u krijua në gusht të vitit 2022 si gjykatë e re, themelimi i të cilës kishte për qëllim përmirësimin e efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, që bien në kompetencë të kësaj gjykate, profilizimin e gjyqtarëve dhe rritjen e vazhdueshme të ekspertizës në këtë fushë. Kjo gjykatë u krijua bazuar në Ligjin nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), si gjykatë e specializuar e shkallës së parë dhe të dytë, kompetente për të zgjidhur të gjitha kontestet e bizneseve, ekonomike, administrative dhe të gjitha ankesat e urdhreve përmbarimore.

22 Gjykata Komerciale, Raporti vjetor i punës për vitin 2024.

Gjykata Themelore e Prishtinës

Sipas LPD-së, kryetarët e gjykatave themelore janë Autoritete Kompetente për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të gjykatave në të cilën shërbejnë. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Prishtinës, është Kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Në këtë gjykatë, përfshirë degët e saj, gjatë vitit 2024 kanë shërbyer **106 gjyqtarë**.²³ Ndërkaq sipas përgjigjeve të pranuar nga zyrtarët e kësaj gjykate, gjatë vitit 2024 **janë parashtuar 32 ankesa disiplinore** ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate. Kjo nënkupton se ky numër ishte rritur dukshëm në krahasim me vitin 2023, ku ishin parashtuar 18 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Nga të gjitha këto ankesa disiplinore, 31 ishin refuzuar/hedhur nga Autoriteti Kompetent, 1 prej tyre ishte hudhur, ndërsa nuk ishte iniciuar ndonjë kërkesë për fillim të hetimeve në KGJK.

Monitorimi i bërë në faqen zyrtare të KGJK-së, përkatësisht në seksionin e dedikuar për Gjykatën Themelore të Prishtinës, tregon se të gjitha vendimet mbi refuzimin apo hedhjen e ankesave janë publikuar në mënyrë transparente. Gjithashtu, të gjitha rastet janë shqyrtuar dhe janë marrë vendime brenda afatit të përcaktuar ligjërisht, duke reflektuar një shkallë të lartë efikasiteti në trajtimin e rasteve disiplinore nga kjo gjykatë.



Numri i ankesave të parashtuara	32
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	31
Numri i ankesave të hedhura	1
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 4

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Gjykatës Themelore e Mitrovicës

Ashtu siç është përcaktuar në LPD, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Në këtë gjykatë, përfshirë edhe degët e saj, gjatë vitit 2024 kanë qenë të angazhuar gjithsej **27 gjyqtarë**²⁴. Ndërkaq sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike të pranuara nga kjo gjykatë, ndaj këtyre gjyqtarëve gjatë vitit 2024 janë parashtruar **6 ankesa disiplinore** nga ana e qytetarëve, 5 prej të cilave ishin refuzuar nga kryetari i gjykatës, përkatësisht Autoriteti Kompetent, ndërsa 1 ankesë është përcjellë në KGJK.

Krahasuar me vitin 2023, kur ishin parashtruar 11 ankesa disiplinore, numri i ankesave në vitin 2024 ka shënuar një rënie të ndjeshme.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të kësaj gjykate, rezulton se të gjitha vendimet lidhur me ankesat disiplinore janë publikuar në ueb-faqe. Po ashtu, është evidentuar se të gjitha ankesat janë trajtuar brenda afateve të përcaktuara me ligj, duke dëshmuar efikasitet të lartë në administrimin e procedurave disiplinore nga kjo gjykatë.



Numri i ankesave të parashtruara	6
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	5
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	1

TABELA 5

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Gjykata Themelore e Pejës

Sipas ligjit, Kryetari i Gjykatës Themelore të Pejës është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Pejës.

Në këtë gjykatë, duke përfshirë degët e saj, gjatë vitit 2024 kanë shërbyer gjithsej **38 gjyqtarë**.²⁵ Rrjedhimisht, ndaj këtyre gjyqtarëve **janë parashtruar 14 ankesa disiplinore**, përkatësisht 1 ankesë më shumë se sa gjatë periudhës së njëjtë për vitin paraprak. Gjithashtu gjatë kësaj periudhë është sjellë 1 vendim për pushim të hetimeve disiplinore për shkak se nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit përkatës.

Prej këtyre ankesave, 12 janë refuzuar dhe 1 është deleguar në Gjykatën Supreme për vendosje.

Të gjitha vendimet mbi këto ankesa janë publikuar në mënyrë të rregullt në faqen zyrtare të gjykatës. Po ashtu, është konstatuar se të gjitha ankesat janë shqyrtuar brenda afateve të përcaktuara me ligj, çka tregon efikasitet në trajtimin e rasteve disiplinore në këtë institucion gjyqësor.

 Numri i Gjyqtarëve 38	Numri i ankesave të parashtruara	14
	Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
	Numri i ankesave të refuzuara	12
	Numri i ankesave të hedhura	0
	Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 6

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

25 Gjykata Themeore e Pejës,Raporti_vjetor_i_punës_për_vitin_2024.

Gjykata Themelore e Prizrenit

Qytetarët e pakënaqur me sjelljet jo-etike dhe jo-profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit, ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate mund t'i parashtrojnë tek Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, në këtë gjykatë (përfshirë degët e gjykatës) kanë qenë të angazhuar gjithsej **31 gjyqtarë**.

Ndërkaq, sipas përgjigjeve të pranuar nga zyrtarët e kësaj gjykate, gjatë vitit 2024 ndaj këtyre gjyqtarëve janë parashtruar **16 ankesa disiplinore** nga ana e qytetarëve (1 më pak se në vitin paraprak). Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga Autoriteti Kompetent. Përveç tyre, gjatë vitit 2024 është iniciuar një rast disiplinor ex officio nga vetë Autoriteti Kompetent, i cili ka përfunduar me konstatimin se gjyqtari nuk ishte përgjegjës për ndonjë shkelje disiplinore.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të gjykatës, rezulton se të gjitha vendimet mbi ankesat e refuzuara janë publikuar. Gjithashtu, në shumicën e rasteve është vendosur brenda afatit të paraparë me dispozitat përkatëse. Megjithatë, në tri vendime disiplinore²⁶, nuk figuron data e paraqitjes së ankesës, gjë që pamundëson verifikimin nëse vendimi është marrë brenda afatit të përcaktuar me ligj.



31

Numri i ankesave të parashtruar	16
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	1
Numri i ankesave të refuzuara	16
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 7

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

26 Vendimi AD-GJTHPZ.nr.1/24; Vendimi AD-GJTHPZ.nr.2/24; Vendimi AD-GJTHPZ.nr.5/24.

Gjykata Themelore e Ferizajt

Kryetari i Gjykatës Themelore të Ferizajt është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Ferizajt.

Gjatë vitit 2024, Gjykata Themelore e Ferizajt, bashkë me degët e saj, kishte të angazhuar gjithsej **30 gjyqtarë**²⁷. Sipas të dhënave të pranuara përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, gjatë kësaj periudhe janë parashtruar **8 ankesa disiplinore** nga qytetarët ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate, që paraqet ulje prej dy ankesash në krahasim me vitin 2023.

Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga Autoriteti Kompetent, ndërkohë që gjatë së njëjtës periudhë është iniciuar edhe 1 kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore ex officio në KGJK.

Nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare të KGJK-së, rezulton se të gjitha vendimet përkatëse janë publikuar në lidhëzën e Gjykatës Themelore të Ferizajt. Po ashtu, për të gjitha ankesat është vendosur brenda afateve të parashikuara me ligj, duke dëshmuar efikasitet dhe transparencë në trajtimin e rasteve disiplinore nga kjo gjykatë.



Numri i ankesave të parashtruara	8
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	1
Numri i ankesave të refuzuara	8
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 8

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.

27 [Gjykata Themelore e Ferizajt, Raporti vjetor i punës për vitin 2024.](#)

Gjykata Themelore e Gjilanit

Kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Gjilanit.

Gjatë vitit 2024, në Gjykatën Themelore të Gjilanit kanë qenë të angazhuar gjithsej **22 gjyqtarë**²⁸. Ndërkaq, sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, gjatë kësaj periudhe qytetarët kanë parashtruar tek Autoriteti Kompetent 16 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate, 14 prej të cilave ishin refuzuar nga Autoriteti Kompetent, ndërsa 2 ankesa ishin hedhur si të palejuara.

Krahasuar me vitin 2023, kur ishin paraqitur 8 ankesa disiplinore, numri i tyre është dyfishuar gjatë vitit 2024, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të shkallës së adresimit të pretendimeve nga qytetarët.

Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe ishin iniciuar 6 ankesa të iniciuar ex-officio nga Autoriteti Kompetent.

Të gjitha vendimet disiplinore ishin publikuar në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së. Gjithashtu, vendimet janë marrë brenda afateve të përcaktuara me ligj, duke dëshmuar efikasitet dhe transparencë në trajtimin e procedurave disiplinore.



Numri i ankesave të parashtruara	16
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	6
Numri i ankesave të refuzuara	14
Numri i ankesave të hedhura	2
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 9

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.

Gjykata Themelore e Gjakovës

Kryetari/ja i/e Gjykatës Themelore të Gjilanit është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Gjilanit.

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën Themelore të Gjakovës kanë qenë të angazhuar **13 gjyqtarë**²⁹. Ndërkaq, sipas përgjigjeve të pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga zyrtarët e këtij institucioni, gjatë këtij viti qytetarët kanë parashtruar **7 ankesa disiplinore** ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Të gjitha këto ankesa disiplinore ishin refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent, ndërsa nuk kishte ankesa të iniciuara sipas detyrës zyrtare nga ana e Autoritetit Kompetent dhe kërkesa për fillim të hetimeve në KGJK.

Krahasuar me vitin 2023, kur ishin parashtruar vetëm 3 ankesa disiplinore, numri i ankesave në vitin 2024 ka shënuar rritje më shumë se dyfish, çka mund të interpretohet si rritje e vetëdijes së qytetarëve se mund të adresojnë pretendimet disiplinore.

Nga monitorimi në ueb-faqen e kësaj gjykate, rezulton se të 7 vendimet mbi refuzimin e ankesave disiplinore ishin publikuar në këtë ueb-faqe dhe se të gjitha ankesat ishin shqyrtuar brenda periudhës së paraparë me ligj, duke treguar efikasitet të lartë në trajtimin e rasteve disiplinore.



13

Numri i ankesave të parashtruara	7
----------------------------------	---

Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
--	---

Numri i ankesave të refuzuara	7
-------------------------------	---

Numri i ankesave të hedhura	0
-----------------------------	---

Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0
--	---

TABELA 10

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Analizë e përgjithshme e shkaqeve të paraqitjes së ankesave ndaj gjyqtarëve dhe arsytimit të vendimeve

Të gjitha vendimet e autoriteteve kompetente lidhur me hedhjen apo refuzimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve janë publikuar në faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kjo qasje përfaqëson një praktikë të mirë institucionale, e cila kontribuon ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor, duke mundësuar një qasje të lirë dhe të qartë për publikun në lidhje me trajtimin e çështjeve disiplinore.

Viti 2024 ka shënuar vazhdimësinë e disa prej shqetësimeve të mëhershme të qytetarëve lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor, por gjithashtu janë evidentuar edhe disa tendenca të reja në natyrën e ankesave.

Ankesat më të shpeshta të parashtruara gjatë kësaj periudhe kanë përfshirë zvarritjen e procedurave gjyqësore, komentimet jo etike në rrjete sociale, përdorimin e gjuhës jo profesionale nga gjyqtarët gjatë seancave, mungesën e komunikimit të vendimeve në afate të arsyeshme, si dhe mosrespektimin e afateve ligjore për përfundimin e shqyrtimit të lëndëve. Në disa raste, qytetarët kanë raportuar gjithashtu mungesë të qasjes efektive në informacionin e nevojshëm mbi rrjedhën e çështjeve të tyre.

Megjithatë, edhe gjatë këtij viti është vënë re një prirje e njëjtë me vitet e kaluara: shumë qytetarë kanë vijuar të përdorin procedurat disiplinore si mjet ankese ndaj vendimeve gjyqësore me të cilat nuk janë pajtuar. Në vend se të shfrytëzojnë mjetet e rregullta ligjore si ankimimi në shkallë më të lartë, ata janë drejtuar te autoritetet disiplinore, shpesh për shkak të njohurive të kufizuara mbi proceset procedurale. Autoritetet Kompetente, në përputhje me mandatin dhe parimet e pavarësisë së gjyqësorit, kanë theksuar sërish se nuk mund të ndërhyjë në përmbajtjen apo rezultatet e aktgjyimeve përfundimtare, përderisa nuk ka elemente të sjelljes së papranueshme apo shkeljes disiplinore nga ana e gjyqtarëve.

Vendimet për refuzimin apo hedhjen poshtë të ankesave disiplinore janë mbështetur në mënyrë të qartë dhe të argumentuar mbi mungesën e elementeve të sjelljes së dënueshme, sipas standardeve të përcaktuara me ligj. Pra, në rastet kur KGJK ka konstatuar se "nuk ka shkelje", vendimet në sistemin gjyqësor janë përgjithësisht të strukturuar dhe të arsyetuara si duhet: prezantojnë faktet relevante, bazën ligjore, arsyetimin analitik dhe konkluzionin.

Në të gjitha rastet e ankesave disiplinore është vendosur brenda periudhës së paraparë me Rregulloren e KGJK, me përjashtim të një vendimi, në të cilin ishte vendosur me 8 ditë vonesë.³⁰

30 Vendimi APGjA.nr.6/2024 (ankesa është bërë me 15 korrik 2024, vendimi është marrë me 23 gusht 2024).

Vendimet përfundimtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Siç është shtjelluar edhe në pjesën e kornizës ligjore, në rastet kur Autoritetet Kompetente nuk i hedhin/refuzojnë ankesat disiplinore të qytetarëve/palëve, autoritetet kërkojnë nga KPK dhe KGJK fillimin e hetimeve disiplinore. Me këtë rast, këshillat krijojnë panelet hetimore, të cilët zhvillojnë hetimet dhe sigurojnë fakte dhe prova në lidhje me shkeljet e pretenduara.

Pas pranimit të raportit nga paneli hetimor, këshilli mbanë seancë dhe vendos nëse është kryer shkelja e supozuar disiplinore dhe, në rast se konstaton se gjyqtari ose prokurori ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore, shqipton sanksionin disiplinor përkatës.

KGJK gjatë vitit 2024 ka pranuar nga autoritetet kompetente 9 kërkesa për fillime të hetimeve disiplinore nga Autoritetet Kompetente të gjykatave të Kosovës.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka themeluar 10 panele hetimore dhe ka mbajtur 13 seanca dëgjimore, duke marrë 9 vendime disiplinore. Përmes këtyre vendimeve, KGJK ka shqiptuar këto masa disiplinore:

- | | |
|---|-------------------------------|
| • Vërejtje publike me shkrim | → (2 vendime); |
| • Vërejtje jopublike me shkrim | → (2 vendime); |
| • Zvogëlim i përkohshëm i pagës për 50% për një periudhë deri në 1 vjet | → (1 vendim); |
| • Lirim nga përgjegjësia | → (4 vendime ³¹). |

31 1 vendim për ankesën e parashtuar gjatë vitit 2023.

Të gjitha këto vendime janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, ndryshe nga praktika e KPK-së, duke përfaqësuar një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës institucionale.

Krahasuar me vitin paraprak³², gjatë vitit 2024 vërehet një prirje drejt masave më të lehta dhe mungesë e masave si "propozimi për shkarkim" apo "transferimi i përhershëm". Kjo lidhet kryesisht me natyrën e rasteve të trajtuara në 2024. Për kontekst, gjatë vitit 2023 janë evidentuar dy propozime për shkarkim; sipas burimeve të jashtme/akteve përkatëse të KGJK*, ato lidhen me pjesëmarrje të gjyqtarëve në takime politike me "Listën Serbe"³³.

Gjatë vitit 2024, nga të dhënat e monitorimit shihet se vendimet janë të strukturuar mirë dhe të arsyetuara në mënyrë kronologjike, duke përshtatur në detaje shkeljet etike apo ligjore të identifikuar dhe duke specifikuar qartë bazën ligjore mbi të cilën janë marrë vendimet.

Megjithatë, objektiviteti dhe paanshmëria e tyre mbetet e vështirë për t'u vlerësuar, pasi procesi i shqyrtimit zhvillohet me diskrecion të plotë nga panelet hetimore dhe mbledhjet e KGJK-së mbahen të mbyllura për publikun, duke kufizuar transparencën mbi vendimarrjen.

Sa i përket konsistencës në shqiptimin e sanksioneve, bazuar në vendimet e publikuara vërehet një konsistencë relative, pra tek shkeljet me profil të ngjashëm zakonisht çojnë në masa të ngjashme. Megjithatë, numri i rasteve të disponueshme nuk lejon ndonjë vlerësim të plotë dhe disa dallime shpjegohen nga rrethanat specifike të çdo rasti.

Në mënyrë grafike, numri dhe lloji i masave disiplinore të marra gjatë vitit 2024 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është vendosur edhe në figurën e mëposhtme.




FIGURA 2

Sanksionet disiplinore të shqiptuara nga KGJK gjatë periudhës janar -dhjetor 2024.

32 Gjatë vitit 2023, masat kanë qenë më të larmishme dhe në disa raste më të ashpra, përfshirë: 2 propozime për shkarkim; 1 vërejtje publike me shkrim e shoqëruar me zvogëlim të përkohshëm të pagës 40% për katër muaj;

2 vërejtje publike me shkrim; 4 lirime nga përgjegjësia disiplinore; 1 transferim i përhershëm i një gjyqtari brenda gjykatës.

33 Shih vendimin e KGJK-se: https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/decisions/16428_Vendimi_KGJK_se_Nr_384_2023.pdf



Trajtimi i ankesave disiplinore nga sistemi prokurorial i Kosovës

5. Trajtimi i ankesave disiplinore nga sistemi Prokurorial i Kosovës

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, qytetarët (personat fizik dhe juridik) kanë parashtruar 58 ankesa disiplinore ndaj prokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës³⁴. Ky numër dëshmon rënie të parashtrimt të ankesave disiplinore ndaj prokurorëve në krahasim me vitin 2023, kur ishin parashtruar 71 ankesa disiplinore.

Pjesa dërmuese e këtyre ankesave të parashtruar gjatë vitit 2024, përkatësisht 54 ankesa disiplinore (93% e ankesave), ishin refuzuar/hedhur nga Autoritetet Kompetente të prokurorive, ndërsa ishin bërë 6 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore në KPK. Këto të dhëna tregojnë se shumica dërmuese e ankesave disiplinore nuk e kanë kaluar fazën fillestare të shqyrtimit nga Autoritetet Kompetente.

Pjesa më e madhe e vendimeve mbi hedhjen/refuzimin e ankesave disiplinore të Autoriteteve Kompetente, *përkatësisht 37 vendime, nuk ishin publikuar në ueb-faqen e KPK-së, në seksionet e prokurorive*. Kjo situatë paraqet një mangësi në aspektin e transparencës dhe qasjes publike në informacion, përkundër praktikave të rekomanduara të llogaridhënies institucionale.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike numri i ankesave disiplinore të parashtruara gjatë vitit 2024, numri i ankesave të hedhura/refuzuara, si dhe numri i kërkesave për fillim të hetimeve në KPK.

34 Të dhëna të siguruara përmes përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike nga ana e prokurorive.

**54**

Numri ankesave
të hedhura/
refuzuara

58

**Numri i ankesave
disiplinore**

4

Numri i kërkesave
për fillim të
hetimeve

FIGURA 3

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në sistemin prokurorial të Kosovës gjatë vitit 2024

Sa i përket shkaqeve të hedhjes/refuzimit të ankesave disiplinore, niveli i ulët i publikimit të vendimeve nga Autoritetet Kompetente e pengon vlerësimin objektiv të arsyeve konkrete të refuzimit/hedhjes së ankesave. Megjithatë, në vendimet e publikuara shihet se arsyet më të shpeshta lidhen me mungesën e elementeve të shkëljes disiplinore, si dhe mospërmbushjen e pragut faktik/juridik për fillim të hetimit disiplinor.

Sa i përket konsistencës në marrjen e vendimeve për raste të ngjashme, vendimet e publikuara nga sistemi prokurorial tregojnë se secili rast i publikuar ka pasur specifika materiale e procedurale (p.sh.ekzistenca e rrethanave lehtësuese/rënduese, sjellja bashkëpunuese, etj.). Këto dallime e bëjnë të pamundur nxjerrjen e një përfundimi të përgjithshëm e të verifikueshëm se shkëljet e ngjashme marrin sanksione të ngjashme brenda sistemit prokurorial.

Në pjesën vijuese të këtij raporti do të paraqiten të dhënat specifike në lidhje me numrin e ankesave të parashtruara dhe trajtimin e tyre nga autoritetet kompetente të prokurorive të Kosovës, si dhe të dhënat në lidhje me numrin e vendimeve dhe masave disiplinore të marra nga KPK.

Përmes paraqitjes së këtyre të dhënave do të pasqyrohet vëllimi i punës së autoriteteve kompetente dhe KPK-së në trajtimin e rasteve disiplinore.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe ka juridiksion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme, si dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjete të jashtëzakonshme juridike. Gjithashtu, Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë në secilën prokurori të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar me ligj.

Sipas LPD-së, Kryeprokurori i Shtetit është Autoriteti Kompetent për të trajtuar ankesat për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryeprokurorëve të të gjitha prokurorive. Ndonëse si pasojë e ndonjë lëshimi, mirëpo në LPD, njëjtë si për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, nuk është përcaktuar Autoriteti Kompetent për t'u ankuar ndaj shkeljeve disiplinore të prokurorëve të angazhuar në ZKPSH.

Ndërsa sipas përgjigjes së pranuar, gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 **nuk ka pasur ndonjë ankesë disiplinore** të parashtruara ndaj Kryeprokurorëve të prokurorive, sikurse gjatë vitit 2023, ku gjithashtu nuk është evidentuar asnjë ankesë në këtë drejtim.

 Numri i ankesave të parashtruara 0	Numri i anesave të parashtruara	0
	Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
	Numri i ankesave të refuzuara	0
	Numri i ankesave të hedhura	0
	Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 11

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në ZKPSH gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Prokuroria e Apelit

Sipas LPD-së, Kryeprokurori i secilës prej prokurorive është përgjegjës për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të prokurorëve të asaj prokurorie.

Në Prokurorinë e Apelit gjatë vitit 2024 kanë qenë të angazhuar **11 prokurorë**. Ndërsa, sipas përgjigjeve të pranura përmes kërkesave për qasje në dokumente publike nga zyrtarët e këtij institucioni, tek Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 **nuk ishte parashtruar ndonjë ankesë disiplinore** nga qytetarët ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie.

Kjo paraqet një rënie të parashtrimit të ankesave krahasuar me vitin 2023, kur ishin parashtruar 2 ankesa disiplinore nga qytetarët. Gjithashtu, gjatë të njëjtës periudhë, nuk është iniciuar asnjë hetim disiplinor ex officio nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit.



11

Numri i ankesave të parashtruara	0
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	0
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 12 Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PA gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.


Prokuroria Speciale

Sipas LPD-së, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale është përgjegjës për të shqyrtuar ankesat sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Në këtë prokurori gjatë vitit 2024 ishin të angazhuar gjithsej **24 prokurorë**. Ndërkaq, sipas të dhënave të siguruara përmes kërkesave për qasje në dokumente publike nga kjo prokurori, gjatë periudhës janar -dhjetor 2024, qytetarët kanë parashtruar **3 ankesa disiplinore** ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie, të cilat ishin refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent. Ndërkaq, gjatë kësaj periudhe nuk ishte iniciuar ndonjë procedurë ex-officio nga Autoriteti Kompetent. Numër të njëjtë a parashtrimi të ankesave disiplinore ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie ishte evidentuar edhe gjatë vitit 2023.

Ndryshe nga prokuroritë tjera, vendimet e kryeprokurorit të kësaj prokurorie nuk ishin publikuar në ueb-faqen e KPK-së, çka përbën një mungesë në aspektin e transparencës institucionale.

Rrjedhimisht, informacionet mbi numrin e ankesave të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie, FOL e ka siguruar vetëm përmes ankesës ne Agjencinë për Informim dhe Privatësi, dhe atë vetëm pasi ky institucion nuk është përgjigjur në kërkesat tona për qasje në dokumente publike.³⁵



Numri i ankesave të parashtruara	3
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	3
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 13 Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PS gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

35 Agjencia për Informim dhe Privatësi, Vendimi A-486/2025, 20 qershor 2025.

Prokuroria Themelore e Prishtinës

Sipas ligjit, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prishtinës është përgjegjës për të shqyrtuar ankesat e parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Në këtë prokurori gjatë vitit 2024 kanë qenë të angazhuar gjithsej **50 prokurorë**.

Sipas përgjigjeve të pranuar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike nga zyrtarët e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, gjatë kësaj periudhe janë parashtruar **20 ankesa disiplinore** ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie, ndërsa 1 kërkesë është iniciuara sipas detyrës zyrtare. Të gjitha ankesat e parashtruara ishin refuzuar nga Autoriteti Kompetent.

Ky numër është ulur dukshëm në krahasim me vitin 2023, kur ishin parashtruar gjithsej 34 ankesa disiplinore ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie.

Nga gjithsej 20 vendime për refuzimin e ankesave disiplinore, të marra nga Autoriteti Kompetent i kësaj prokurorie, vetëm 8 prej tyre janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të institucionit. Nga monitorimi i këtyre 8 vendimeve të publikuara, rezulton se Autoriteti Kompetent ka vendosur brenda afatit të përcaktuar me ligj, duke respektuar kërkesat procedurale për kohështirjen e trajtimit të ankesave.



50

Numri i ankesave të parashtruara	20
----------------------------------	----

Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	1
--	---

Numri i ankesave të refuzuara	20
-------------------------------	----

Numri i ankesave të hedhura	0
-----------------------------	---

Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0
--	---

TABELA 14 Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PThP gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Prokuroria Themelore e Mitrovicës

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2024, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **19 prokurorë**. Ndërkaq, sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike nga ky institucion, gjatë kësaj periudhe është parashtruar vetëm **1 ankesë disiplinore** ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie, njejtë sikurse gjatë vitit 2023, duke treguar një vazhdimësi në nivelin e ulët të paraqitjes së ankesave.

Kjo ankesë ishte refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent. Ndërsa në anën tjetër, nuk kishte ndonjë kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ex-officio.

Vendimi për refuzimin e ankesës është publikuar në ueb-faqen zyrtare të KPK-së dhe është marrë brenda afatit të përcaktuar ligjërisht, duke reflektuar respektimin e standardeve procedurale në trajtimin e rasteve disiplinore.



Numri i ankesave të parashtruara	1
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	1
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 15

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në P.Th. e Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.

Prokuroria Themelore e Pejës

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2023, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **17 prokurorë**.

Sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike nga ky institucion, gjatë kësaj periudhe janë parashtruar **14 ankesa disiplinore** ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Prej tyre, 12 ankesa disiplinore janë refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent. Kërkesa për fillim të hetimeve ex-officio nuk kishte pasur. Ndërsa gjatë kësaj periudhe ishin bërë 2 kërkesa për fillim të procedurës disiplinore.

Numër relativist të njejtë të ankesave ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie kishte pasur edhe gjatë vitit 2023, ku ishin parashtruar 13 ankesa disiplinore, 12 prej të cilave ishin refuzuar.

Asnjë vendim mbi ankesat disiplinore të parashtruara nuk është publikuar në ueb-faqen e KPK-së, që ngrit shqetësime për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies në trajtimin e çështjeve disiplinore nga ky institucion.



17

Numri i ankesave të parashtruara	14
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	12
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	2

TABELA 16

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në P.Th. e Mitrovicës gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.

Prokuroria Themelore e Prizrenit

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2023, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **22 prokurorë**. Ndërkaq sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, janë parashtruar 9 ankesa disiplinore nga ana e qytetarëve për prokurorët e kësaj prokurorie, 7 prej të cilave ishin refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë bërë 2 kërkesa për fillim të hetimeve.

Numër të njëjtë të ankesave disiplinore prokurorët e kësaj prokurorie kishin pasur edhe gjatë vitit 2023, ku ishin parashtruar gjithsej 9 ankesa disiplinore.

Në ueb-faqen zyrtare të KPK-së shihet së janë publikuar vetëm 3 vendime mbi ankesat disiplinore të parashtruara gjatë kësaj periudhe, përkatësisht nga 9 sosh, që ngrit pikëpyetje mbi përkushtimin e institucionit ndaj transparencës dhe informimit të publikut. Nga analiza e përgjithshme e 3 vendimeve të publikuara, shihet se për pretendimet e ngritura është vendosur brenda afatit të paraparë në ligj dhe rregullore.



22

Numri i ankesave të parashtruara	9
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	7
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	2

TABELA 17

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PTh. e Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Prokuroria Themelore e Ferizajt

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Ferizajt është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2023, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **18 prokurorë**.

Sipas përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 janë parashtruar gjithsej **2 ankesa disiplinore** nga ana e qytetarëve për prokurorët e kësaj prokurorie, ankesa këto të cilat ishin refuzuar nga ana e Autoritetit Kompetent. Ndërsa nuk kishte kërkesa ex officio, dhe kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore në KPK.

Krahasuar me vitin 2023, kur ishin parashtruar 3 ankesa disiplinore, numri i ankesave ka shënuar një rënie të lehtë, duke reflektuar gjithashtu një trend të përgjithshëm të ulët të paraqitjes së ankesave ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie.

Vendimet për refuzimin e ankesave të paraqitura janë publikuar në faqen zyrtare të KPK-së. Nga analiza e këtyre vendimeve rezulton se autoriteti kompetent ka vepruar brenda afatit të parashikuar për shqyrtimin e pretendimeve, dhe vendimet janë të argumentuara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar. Megjithatë, është vërejtur se në këto vendime, vendimet janë kategorizuar gabimisht si 'hedhje' në vend të 'refuzimit', ndonëse arsyeja reale e mospranimit ka qenë mungesa e vërtetimit të kryerjes së shkeljes disiplinore.



18

Numri i ankesave të parashtruara	2
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	0
Numri i ankesave të hedhura	2
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 18

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në P.Th. e Ferizajt gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Prokuroria Themelore e Gjilanit

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Gjilanit është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2024, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **16 prokurorë**.

Sipas përgjigjeve të pranuar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë parashtruar **3 ankesa disiplinore** nga qytetarët ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga Autoriteti Kompetent.

Numri i ankesave për vitin 2024 ka shënuar një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 2023, kur ishin parashtruar 5 ankesa disiplinore.

Vendimet përkatëse janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të KPK-së dhe sipas monitorimit, për secilën ankesë është vendosur brenda afatit të përcaktuar me ligj dhe rregullore. Gjithashtu, vendimet kanë qenë të arsyetuara dhe të mbështetura në dispozita ligjore.



Numri i ankesave të parashtruara	3
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	3
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 19

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PTh. e Gjilanit gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Prokuroria Themelore e Gjakovës

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Gjakovës është Autoriteti Kompetent për të shqyrtuar ankesat disiplinore të parashtruara ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2024, në këtë prokurori kanë qenë të angazhuar gjithsej **15 prokurorë**.

Sipas përgjigjeve të pranuar nga zyrtarët e prokurorisë përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë parashtruar **4 ankesa disiplinore** nga qytetarët ndaj prokurorëve të kësaj prokurorie. Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga Autoriteti Kompetent. Gjatë kësaj periudhe nuk është iniciuar asnjë procedurë ex officio, dhe nuk është bërë asnjë kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore në KPK.

Nga gjithsej 4 vendime të marra, vetëm 2 janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të KPK-së. Për këto 2 vendime të publikuara rezulton se është vendosur brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe rregullore, duke respektuar kriteret procedurale për trajtimin e ankesave.



Numri i ankesave të parashtruara	4
Numri i ankesave të filluara sipas detyrës zyrtare	0
Numri i ankesave të refuzuara	4
Numri i ankesave të hedhura	0
Numri i kërkesave për fillim të hetimeve	0

TABELA 20

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore në PTh. e Gjakovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Analizë e përgjithshme e shkaqeve të paraqitjes së ankesave ndaj gjyqtarëve dhe arsyetimit të vendimeve

Ndryshe nga KGJK, KPK vazhdoi edhe gjatë vitit 2024 të mos publikojë të gjitha vendimet lidhur me refuzimin apo hedhjen e ankesave disiplinore, një praktikë që është mbajtur edhe gjatë vitit 2023. Gjatë atij viti, ankesat disiplinore ndaj prokurorëve janë trajtuar si të dhëna konfidenciale nga kryeprokurorët përkatës dhe nuk janë bërë të qasshme për publikun. Për këtë arsye, Lëvizja FOL kishte dorëzuar ankesë pranë AIP-së, duke kundërshtuar refuzimin e KPK-së për të ofruar qasje në dokumentet publike mbi vendimet disiplinore. Si rezultat, AIP me vendimin nr. AP-397/2024 të datës 24 qershor 2024 e detyroi KPK-në të lejojë qasjen në këto dokumente, duke theksuar se refuzimi i mëparshëm ishte i pajustificueshëm dhe në kundërshtim me të drejtën për informim.

Gjatë vitit 2024, nga gjithsej 51 vendime disiplinore për refuzim/hedhje të ankesave të marra nga Autoritetet Kompetente, vetëm 14 janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të KPK-së, ndërsa 37 vendime (rreth 72.5%) nuk janë publikuar fare në ueb-faqen zyrtare të KPK-së, përkatësisht në domenet përkatëse të prokurorive. Kjo situatë paraqet një mangësi serioze në transparencë dhe kufizon qasjen e publikut në informacion, duke u larguar nga standardet e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies që priten nga institucionet e drejtësisë.

Një qasje e tillë jo vetëm që minon besimin e qytetarëve në sistemin prokurorial, por gjithashtu ndikon negativisht në përpjekjet për ndërtimin e një kulture të llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm institucional. Pa publikimin e rregullt të këtyre vendimeve, është e pamundur të bëhet një vlerësim i plotë dhe objektiv i mënyrës se si trajtohen ankesat ndaj prokurorëve.

Nga analiza e përgjithshme e vendimeve të disponueshme për vitin 2024, vërehet se nga arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankesave ka qenë shkelja e Kodit të Etikës Profesionale të Prokurorëve, veçanërisht në sjelljen e tyre gjatë seancave gjyqësore. Ankesa të shumta nga qytetarët kanë shprehur shqetësime për qasjen jo profesionale të disa prokurorëve, si dhe për mënyrën se si është administruar procesi gjyqësor në tërësi.

Ndonëse mospublikimi i një pjese të konsiderueshme të vendimeve të Autoriteteve Kompetente e kufizon vlerësimin gjithëpërfshirës mbi cilësinë e arsyetimit, muund të thuhet se aty ku dokumentet janë të disponueshme, arsyetimi paraqitet i mjaftueshëm (përshkrim i fakteve, bazë ligjore dhe analizë përfundimtare).

Provat e paraqitura dhe të përfshira në përmbajtjen e vendimeve janë konsideruar të mjaftueshme për të justifikuar vendimet për hedhjen apo refuzimin e ankesave, por mungesa e transparencës së plotë dhe mospublikimi i të gjitha vendimeve e bën të vështirë një vlerësim tërësor dhe objektiv të cilësisë së trajtimit të tyre.

Sa i përket respektimit të afateve ligjore, në vendimet e publikuara shihet se autoritetet kompetente kanë vepruar brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe rregullore. Në rastet e analizuara, nuk janë evidentuar tejkalime të afateve procedurale.

Vendimet përfundimtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Bazuar në përgjigjet e siguruara përmes kërkesave për qasje në dokumente publike të zyrtarëve të prokurorive, KPK gjatë vitit 2024 ka pranuar 6 kërkesa për fillim të hetimeve disiplinore nga Autoritetet Kompetente (Kryeprokurorët e Prokurorive).

Sipas raportit vjetor të KPK-së për vitin 2024, gjatë këtij viti, KPK përmes paneleve hetimore ka marrë 4 vendime disiplinore për lëndët e vitit 2024 dhe ka shqiptuar këto masa disiplinore³⁶:

- "Vërejtje jo publike me shkrim" → (1 vendim);
- "Zvogëlim i pagës për 30% për periudhë 6 mujore" → (1 vendim);
- "Zvogëlim i pagës për 20% për një periudhë 3 mujore" → (2 vendime);

Pra kjo nënkupton se pjesa më e madhe e masave disiplinore të shqiptuara nga KPK gjatë vitit 2024 kanë qenë vërejtje jo publike. Gjithashtu, këto vendime të KPK-së nuk gjenden të publikuara në ueb-faqen zyrtare të këtij institucioni.

Në mënyrë grafike, lloji i sanksioneve disiplinore të shqiptuara nga KGJK mund të gjendet edhe në figurën e mëposhtme.




FIGURA 4

Sanksionet disiplinore të shqiptuara nga KPK gjatë periudhës janar -dhjetor 2024.

36 Për më tepër, shih: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti i Punës për vitin 2024.

6. Ankesat e parashtuara tek Avokati i Popullit

Për shkak të rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, LPD ka lejuar mundësinë e parashtimit të ankesave disiplinore nga personat fizik dhe juridik për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe tek Avokati i Popullit. Ky mekanizëm shtesë u ofron një kanal të rëndësishëm për të raportuar sjelljet e pahijshme të autoriteteve gjyqësore dhe prokuroriale, duke siguruar një mbikëqyrje më të gjerë mbi sistemin e drejtësisë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Avokati i popullit ka pranuar 12 ankesa disiplinore, 8 prej të cilave janë shpallur të papranueshme për shkak se nga përmbajtja e tyre kanë qenë të parashtuara nga palët për shkak të pakënaqësive me vendimet gjyqësore dhe nuk janë parashtuar për çështje disiplinore.

Ankesat e shpallura të pranueshme janë proceduar në KGJK dhe në KPK, dhe në 3 raste, këshillat nuk kanë gjetur asnjë shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas pretendimeve të ankuesve, ndërsa 1 rast është në fazën e hetimeve.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur numri i ankesave të parashtuara nga qytetarët tek Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe numri i ankesave të pranueshme dhe të papranueshme.



Numri i anesave të parashtuara qytetarë	12
Numri i ankesave të shpallura të pranueshme	4
Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	8
Numri i shkeljeve disiplinore të evidentuara nga KPK dhe KGJK	0

TABELA 21

Të dhënat statistikore në lidhje me ankesat disiplinore të proceduara tek Avokati i Popullit gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

7. Rekomandime

Bazuar në konkluzionet e këtij raporti dhe synimit për të rritur efikasitetin e trajtimit të çështjeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, Lëvizja FOL jep rekomandimet e mëposhtme:

- **KPK të vendosë formularin për paraqitjen e ankesave disiplinore në një pjesë më të dukshme dhe të qasshme në ueb-faqen zyrtare, në mënyrë që qytetarëve t'u lehtësohet qasja dhe ushtrimi i kësaj të drejte.**

- **Të publikohen të gjitha vendimet mbi refuzimin/hedhjen e ankesave disiplinore në ueb-faqen zyrtare të KPK-së dhe KGJK-së. Kjo do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.**

- **Në baza të rregullta mujore, KGJK dhe KPK të informojnë qytetarët për të dhënat periodike për parashtrimin e ankesave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve.**

- **Të respektohet në përpikmëri afati prej 30 ditësh për trajtimin e ankesave disiplinore, si dhe të njoftohen me kohë palët për vendimin e marrë.**

- **Të shqiptohen masa më të ashpra disiplinore ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve nga këshillat përkatës në rastet kur ndaj të njëjtëve shqiptohen disa herë radhazi sanksione disiplinore, meqenëse aktualisht nuk ka ndonjë mekanizëm të unifikuar dhe të standardizuar për të evidentuar dhe ndëshkuar më ashpër rastet kur ka shkelje të përsëritura në të dy sistemet.**

- **Të organizohen fushata të përbashkëta të KGJK-së dhe KPK-së, me qëllim të promovimit dhe inkurajimit të qytetarëve që të ushtrojnë të drejtën e ankesës kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve.**
